


Rifinah



Rifinah është një kombinim i dy ilaçeve
(Rifampicin dhe Isoniazid) në një tabletë.

Përpara se të merrni Rifinah:

Tregojini doktorit tuaj rreth:

- Të gjithë ilaçeve të tjera që ju jeni duke marrë, përfshirë ato që ju blini në sportel në një farmaci lagjeje.
- Ndonjë alergji të mëparshme nga ndonjë ilaç tjetër
- Ndonjë sëmundjeje në mëlçi, nëse keni pasur

Marrja e Rifinah-it

E njëjta procedurë si Rifater-i

Efektet anësore

Të njëjtat si Rifater-i

Mbroni të gjithë familjen dhe miqtë nga TB - merrni ilaçet e TB-së

Mos harroni se Infermierja e tuberkulozit është këtu për t'ju ndihmuar dhe për t'ju këshilluar gjatë të gjithë trajtimit tuaj. Ju lutemi kontaktoni infermierin tuaj të tuberkulozit nëse nuk ndiheni mirë gjatë trajtimit tuaj ose nëse ka ndonjë gjë që jeni të pasigurt për mjekimin tuaj.

Infermierja juaj e tuberkulozit është:

Doktori juaj në spital është:

Nr. i kontaktit:

E-maili:

TB Alert është një vepër unike bamirësie, që rrit ndërgjegjshmërinë për Tuberkulozin në Mbretërinë e Bashkuar dhe që po mbështet punën e NHS-së, duke ofruar informacione për pacientët. Ne mbështesim projektet në vendet që janë në zhvillim duke siguruar që të gjithë pacientët të marrin trajtimin e duhur. Me mbështetjen tuaj, ne mund të arrijmë një ndikim shumë të madh pozitiv, në mbarë botën për tuberkulozin dhe të shpëtojmë më shumë jetë.



TB Alert,
Community Base,
113 Queens Road,
Brighton BN1 3XG
Tel: 01273 234030

Për informacione të mëtejshme ose për kopje të kësaj broshure, ju lutemi kontaktoni 01273 234 770 (vetëm në orarin zyrtar).

Për të bërë një donacion ose për të dalë vullnetar për të ndihmuar **TB Alert**, ju lutemi kontaktoni 01273 234 784 (vetëm në orarin zyrtar).

Ose vizitoni faqen tonë të internetit në www.tbalert.org

Informacioni i dhënë në këtë broshurë rreth tuberkulozit rezistues ndaj shumë ilaçeve ka si synim të japë informacion të përgjithshëm rreth subjektit. Ai nuk mendohet të zëvendësojë njohuritë, ekspertizën, aftësitë dhe gjykimin e infermieres/doktorit tuaj të tuberkulozit ose të profesionistëve të tjerë të shëndetësisë. Asnjë nga informacionet që përmban kjo broshurë nuk mendohet të përdoret për të marrë vendime për diagnoza ose për kurim. Pyetjet dhe problemet në lidhje me diagnozën dhe kurimin duhet t'i drejtohen një profesionisti të kujdesit shëndetësor.

Punim origjinal kërkimor nga North West London TB Network

Rifater, Ethambutol, Pyrazinamide dhe Rifinah



je e madhe gjatë natës
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës. Me ose pa kollë
Temperaturë!! Temperaturë!! Temperaturë!!
Djersitje e madhe gjatë natës. Me ose pa kollë
Gjendra të ënjtura Gjendra të ënjtura
Temperaturë!! Humbje e pashpjegueshme në peshë
Temperaturë!! Djersitje e madhe gjatë natës
Djersitje e madhe gjatë natës Me ose pa kollë



Rifater



Rifater-i është një kombinim i tre ilaçeve (Rifampicin, Isoniazid dhe Pyrazinamide) në një tabletë.

Para marrjes së Rifater-it

Tregojini doktorit tuaj rreth:

- Të gjithë ilaçeve të tjera që ju jeni duke marrë, përfshirë ato që ju blini në sportel në një farmaci lagjeje
- Ndonjë alergji të mëparshme nga ndonjë ilaç tjetër
- Ndonjë sëmundjeje në mëlçi, nëse keni pasur

Marrja e Rifater-it

Rifater-i absorbohet më mirë kur stomaku është bosh. Merreni Rifater-in gjysmë ore para ngrënies. Mjeku ose infermiera juaj do të diskutojnë me ju kohën më të përshtatshme të ditës për të marrë Rifater-in.

Efektet anësore

Rifater-i, ashtu si të gjithë ilaçet e tjera, mund të ketë disa efekte anësore:

- Çrregullime të stomakut si të përziera (ndjesi e të qenit sëmurë) të vjella dhe diarre
- Simptoma të ngjashme me gripin si të dridhura, ethe, marrje mendsh dhe dhimbje kockash
- Verdhëz (zverdhje e lëkurës ose e syve). Nëse ju vëreni këtë, ju lutemi t'i ndërpritni të gjitha ilaçet dhe të kërkon menjëherë kujdes mjekësor
- Acarime të lëkurës dhe kruajtje
- Çrregullime menstruale
- Neuropati periferike (pickime dhe shpime në gishtat e duarve dhe këmbëve)

- Sekretionet e trupit (urina, pështyma, sperma, lëngjet vagjinale do të jenë në ngjyrë portokalli në të kuqe. Kjo është normale dhe jo arsye për t'u shqetësuar; nëse urina juaj është e errët përpara se të merrni Rifater-in, tregojini doktorit ose infermieres suaj. Lentet e kontaktit mund të çngjyrosen gjithashtu.
- Efikasiteti i kontraktivëve hormonalë (nga goja, implante ose të tjera) reduktohet. Do t'ju nevojiten metoda të tjera ose shtesë për mbrojtjen; pyesni doktorin ose infermieren për këshilla.

Ethambutol



Përpara marrjes së Ethambutol-it

Tregojini doktorit tuaj rreth:

- Të gjithë ilaçeve të tjera që ju jeni duke marrë, përfshirë ato që ju blini në sportel në një farmaci lagjeje.
- Ndonjë alergji të mëparshme nga ndonjë ilaç tjetër.


Marrja e Ethambutol-it

Ethambutol-i mund të merret përpara ose pas ngrënies. Mjeku ose infermiera juaj do të diskutojnë me ju kohën më të përshtatshme të ditës për të marrë Ethambutol-in.

Efektet anësore

Ethambutol-i rrallë mund të shkaktojë çrregullime të shikimit (turbullim dhe çrregullim të ngjyrës së kuqe/jeshile). Doktorit ose infermiera juaj do të lenë një takim që ju të kryeni një test të syve përpara se të filloni Ethambutol-in. Nëse ju zhvillohen çrregullimet e mësipërme të shikimit ndërkohë që merrni Ethambutol, ju lutemi ndërpritni marrjen e tij dhe njoftoni menjëherë doktorin ose infermieren tuaj.

Pyrazinamide



Përpara marrjes së Pyrazinamide-s

Tregojini doktorit tuaj rreth:

- Të gjithë ilaçeve të tjera që ju jeni duke marrë, përfshirë ato që ju blini në sportel në një farmaci lagjeje
- Ndonjë alergji të mëparshme nga ndonjë ilaç tjetër
- Nëse keni pasur ndonjë sëmundje mëlçie

Marrja e Pyrazinamide-s

Pyrazinamide mund të merret përpara ose pas ngrënies. Mjeku ose infermiera juaj do të diskutojnë me ju kohën më të përshtatshme të ditës për të marrë Pyrazinamide-n.

Efektet anësore

Pyrazinamide, ashtu si të gjithë ilaçet e tjera, mund të ketë disa efekte anësore:

- Çrregullime të stomakut si të përziera (ndjesi e të qenit sëmurë) të vjella dhe diarre
- Simptoma të ngjashme me gripin si të dridhura, ethe, marrje mendsh dhe dhimbje kockash
- Verdhëz (zverdhje të lëkurës ose syve). Nëse ju vëreni këtë, ju lutemi t'i ndërpritni të gjitha ilaçet dhe të kërkon menjëherë kujdes mjekësor
- Acarime të lëkurës dhe kruajtje